



## REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

### AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Up1 Nr. 03-255

06.09.2022

#### Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 20 dhe nenit 23 paragrafi 1 alineja 1 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/1 3, 13/14, 44/14, 1 01/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20 dhe 77/21), e në lidhje me nenin 64 paragrafi 1 i Ligjit të njëjtë, pika 5 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim për aktvendimet e Agjencisë për ndërmarrje të masave ("Tekst i konsoliduar) nr. 01-6039/1 nga data 20.10.2015, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore nr. 10-3128/1 nga data 15.08.2022 dhe Konkluzioni me nr. ark. 02-3312/3 nga 6.09.2022, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike, në seancën e 34-të të mbajtur më 06.09.2022 e miratoi aktvendimin në vijim:

#### **Aktvendim për ndërmarrje të masës – vërejtje publike**

1. VËREJTJE PUBLIKE Shoqërisë tregtare për veprimtari radiodifuzive (SHTR) TV SONCE SHPKNJP Prilep, për shkak të shkeljes së nenit 64 paragrafi 1 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (LSHMAAV), në mënyrë që në kuadër të servisit të tij programor, të transmetuar më 3 gusht 2022, një pjesë e emisionit "Maqedonia magjike", një pjesë e dy edicioneve të saj reprize, si dhe tre njoftime për emisionin "Turizmi maqedonas", janë transmetuar në gjuhën angleze, pa u siguruar përkthim në gjuhën maqedonase.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është përcaktuar në raportin me shkrim për mbikëqyrjen e programit, nr. 10-3128/1 nga 15.08.2022, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi si shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET shoqëria tregtare për veprimtari radiodifuzive TV SONCE SHPKNJP Prilep që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet kontroll mbikëqyrës për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Vendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij konsiderohet dita e verifikimit të tij në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizive Mediatike.

#### **Arsyetimi**

Agjencia në bazë të nenit 28 nga LSHMAAV është kompetente për mbikëqyrjen programore (monitorim) të programeve të radiodifuzerëve dhe ofruesve të shërbimeve Mediatike Audiovizuale me kërkesë, si dhe të pakove programore që i ritransmetojnë operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik në aspekt të respektimit të dispozitave të Ligjit të cituar, lejet, vërtetimet e lëshuara për regjistrim, aktet nënligjore si dhe aktet e tjera të miratuara nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 1 alineja 1 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë – aktvendim për vërejtje publike në pajtim me Ligjin, në rastet kur është bërë shkelje e dispozitave të LSHMAA dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij, si dhe kushtet dhe obligimet e përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 64 paragrafi 1 të LSHMAAV, radiodifuzerët kanë për obligim ta transmetojnë programin në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik, e në rastet kur programi është dedikuar për komunitetin që nuk është shumicë, në gjuhën dhe alfabetin e atij komuniteti.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia përmes Sektorit për punë programore, më 15 gusht 2022, bëri mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të servisit programor televiziv të Shoqërisë tregtare për veprimtari radiodifuzive TV SONCE SHPKNJP Prilep, të transmetuar më 3 gusht 2022, në nivel shtetëror, me ç'rasdt konstatoi shkelje të nenit 64 paragrafi 1 të LSHAAMV.

Me mbikëqyrjen e rregullt është konstatuar se më 3 gusht 2022, në servisin programor televiziv të SHRT TELEVISIONI SONCE SHPKNJP Prilep, një pjesë të emisionit "Maqedonia magjike", një pjesë e dy edicioneve të saj reprize, si dhe tre njoftime për emisionin "Turizmi maqedonas" transmetohet në gjuhën angleze, pa u siguruar përkthim në gjuhën maqedonase.

Shkelja nga pika 1 e këtij vendimi është përcaktuar në raportin me shkrim për mbikëqyrjen e programit, nr. 10-3128/1 datë 15.08.2022, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi si Shtojcë nr.1.

Në bazë të nenit 23 paragrafi 3 të LSHAAM, Këshilli i Agjencisë Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion Prilep, më 16.08.2022, i dorëzoi Shkresë nr. ark. 10-3128/2 nga 16.08.2022 me të cilin ia dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programor nr. ark. 10-3128/1 nga 15.08.2022 me qëllim brenda 7 (shtatë) ditëve të punës nga dita e shkresës së pranuar Këshillit të Agjencisë ti dorëzohet prononcim me shkrim për shkeljen e bërë të dispozitave të LSHAAM. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregull nga radiodifuzeri më datë 17.08.2022. Në afatin e paraparë, Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SONCE SHPKNJP nuk u prononcua për shkeljen e bërë të dispozitave të LSHAAM. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më datë 06.09.2022 e shqyrtoi raportin me shkrim dhe konkludoi që SHRT TV SONCE SHPKNJP Prilep, t'i shqiptojë masë – vërejtje publike.

Si rezultat i sa më sipër, bazuar në nenin 18 paragrafi 1 alineja 20 dhe neni 23 paragrafi 1 alineja 1 të Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike, kurse në lidhje me nenin 64 paragrafi 1 të të njëjtit ligj, pika 5 e Udhëzimit për caktimin e afatit për veprim për Aktvendimet e Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raporti me shkrim për mbikëqyrjen programore nr. ark. 10-3128/1 nga 15.08.2022, dhe Konkluzioni nr. ark. 02-3312/3 nga 06.09.2022 për shkak të konstatimit të mos respektimit të dispozitave të Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike, të përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike, në seancën e mbajtur më 06.09.2022 miratoi Aktvendim me të cilin qortohet publikisht Shoqëria tregtare për veprimtari radiodifuzive TV SONCE SHPKNJP Prilep dhe i imponohet, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të bëhet mbikëqyrje kontrolluese me qëllim të konstatimit nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi ka vepruar për Aktvendimin.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAA, ky Vendim është përfundimtar dhe kundër tij radiodifuzeri mund të parashtrijë padi për iniciimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ parashtrijë në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të Aktvendimit.

Në bazë të të lartpërmendurës, u miratua aktvendimi si në dispozitivin.

#### **Shtojcë (1):**

- 1) Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, nr. 10-3128/1 nga 15.08.2022

**Agjencia për shërbime Mediatike  
audio dhe Audiovizuale  
Kryetar i Këshillit  
Llazo PETRUSHEVSKI, d.v**

**Këshill juridik:** Kundër këtij aktvendimi, radiodifuzeri mund të parashtrojë padi për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicim të kontestit administrative parashtrohet në 30 ditë nga dita e pranimin të aktvendimit.

Dorëzuar deri te:

- Shoqëria radiodifuzive tregtare TELEVISIONI SONCE SHPKNJP Prilep;
- Drejtori i Shoqërisë radifuzive tregtare TELEVISIONI SONCE SHPKNJP Prilep;
- Personi përgjegjës i programit në Shoqërinë radiodifuzive tregtare TELEVISIONI SONCE SHPKNJP Prilep
- Sektori për Çështje Juridike dhe Furnizime Publike;
- Sektori për Çështje Programore;
- Personat e emëruar të Agjencisë për udhëheqje të regjistrit

Drejtuar: Dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike

Në bazë të nenit 28 të Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 27/19) dhe Ligjit për ndryshimin e Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 42/20 dhe 77/21) dorëzohet:

### RAPORT ME SHKRIM PËR MBIKËQYRJEN E KRYER PROGRAMORE

1. Lloji i mbikëqyrjes: E rregullt;
2. Subjekti i mbikëqyrjes: Servisi programor televiziv i Shoqërisë radiodifuzive tregtare TV SONCE Prilep;
3. Periudha e përfshirë me mbikëqyrjen: 3 gusht 2022;
4. Data e kryerjes së mbikëqyrjes: 15 gusht 2022;
5. Lënda e mbikëqyrjes:
  - Neni 64 i Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike (përdorimi i gjuhës në programet e radiodifuzerëve);
  - Neni 90 i Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike (radiodifuzerët që kryejnë veprimtari në nivel rajonal janë të obliguar në bazë ditore të transmetojnë së paku 12 orë program të televizionit);
  - Neni 92 paragrafët 1 dhe 3 të Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike (Shoqëritë radiodifuzive tregtare që transmetojnë servis programor televiziv obligohen në bazë ditore të transmetojnë së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audio ose audiovizuale, ndërsa servisi programor televiziv janë obliguar së paku gjysma e obligimeve të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni t'i realizojnë në periudhë nga ora 7,00 deri në ora 19:00).
6. Masa e shqiptuar paraprake:/
7. Konstatime nga mbikëqyrja:

Me mbikëqyrje të rregullt programore mbi servisin programor televiziv të SHRT TV SONCE SHPKNJP Prilep, të transmetuar më 3 gusht 2022, në nivel shtetëror, është konstatuar shkelje e nenit 64 paragrafi 1 të Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike (radiodifuzerët janë të obliguar që ta transmetojnë programin në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik, e në rastet kur programi është dedikuar për komunitetin që nuk është shumicë, në gjuhën dhe alfabetin e atij komuniteti që nuk është shumicë, në gjuhën dhe alfabetin e atij komuniteti)

Me mbikëqyrjen është konstatuar se më 3 gusht radiodifuzive TV SONCE SHPKNJP Prilep, një pjesë e emisionit "Maqedonia magjike", një pjesë e të dy edicioneve të saj reprize, si dhe tre njoftime për emisionin "Turizmi maqedonas", u transmetuan në gjuhën angleze, pa u siguruar përkthim në gjuhën maqedonase.

Titulli	Periudha e transmetimit Fillimi	Fundi	Përshkrimi
"Maqedonia Magjike" – premierë	06:13:40	06:14:33	Një pjesë e emisionit "Maqedonia magjike", një pjesë e të dy edicioneve të saj reprize, si dhe tre njoftime për emisionin "Turizmi maqedonas", u
"Maqedonia Magjike" – reprizë	19:33:30	19:34:16	

“Maqedonia Magjike” – reprizë	23:12:02	23:12:49	transmetuan në gjuhën angleze, pa u siguruar përkthim në gjuhën maqedonase.
Njoftim për emisionin “Turizmi maqedonas”	06:35:39	06:36:31	
Njoftim për emisionin “Turizmi maqedonas”	19:55:28	19:56:14	
Njoftim për emisionin “Turizmi maqedonas”	23:34:01	23:34:47	

#### 8. **Përshkrimi i shkeljes:**

Në kundërshtim me nenin 64 paragrafi 1 të Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike, servisi programor televiziv i Shoqërisë tregtare për veprimtari radiodifuzive TELEVISIONI SONDE SHPKNJP Prilep, më 3 gusht 2022, një pjesë e emisionit “Maqedonia magjike”, një pjesë e të dy edicioneve të saj reprize, si dhe tre njoftime për emisionin “Turizmi magjik”, u transmetuan në gjuhën angleze, pa u siguruar përkthim në gjuhën maqedonase.

#### 9. **Propozimi i masës:**

- Këshilli i Agjencisë të miratojë aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike të Shoqërisë radodifuzive tregtare TV SONCE SHPKNJP Prilep, dhe në pajtim me pikën 5 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve në Agjencinë për ndërmarrje të masës nr. 01-6039/1 nga 20.10.2015, t’i imponojë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit ta harmonizojë punën e tij me dispozitat e nenit 64 paragrafi 1 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale dhe

- Të kryhet mbikëqyrje kontrolluese, me qëllim të konstatimit nëse subjekti i mbikëqyrjes (radiodifuzeri) ka vepruar sipas masës së shqiptuar vërejtje publike (në tërësi, pjesërisht ose nuk ka vepruar), pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktin e veçantë (aktvendim), të miratuar nga Këshilli i Agjencisë.

#### ***Sektori për punë programore***